EKSTRAKT I KUSHTEVE TË KONTRATES SË SIGURIMIT
JETË DHE SHËNDET VIZITORI

Në zbatim të Ligjit Nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" Shoqëria e Sigurimit SiCRED sh.a. dhe Statutit e shoqërisë SiCRED sh.a. paraqesim si vijon ekstrakt të kushteve të Kontratës së Sigurimit.

Kontrata e Sigurimit Jetë dhe Shëndet Vizitori është kontrata me anë të së cilës, Siguruesi dhe i Siguruari bien dakord që kundrejt pagimit të primit të sigurimit në favor të Siguruesit, në përputhje me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta (nëse ka) të kësaj kontrate, siguruesi do të dëmshpërblejë të Siguruarin në mënyrën dhe masën e parashikuar në këtë kontratë, nëse ndodh të vërtetohet rasti i sigurimit.

1.1 Përcaktime

- ***a)*** ***Përfitimi për Vdekjen Natyrale –*** i paguhet të siguruarit në rast të humbjes së jetës për shkaqe natyrore brenda periudhës së sigurimit;
- ***b)*** ***Shpenzimet Mjekësore –*** i paguhen të siguruarit nëse ka nevojë për trajtim dhe ndihmë mjekësore si pasojë e një aksidenti apo sëmundje.
- ***c)*** ***Përfitimet nga Aksidentet Personale*** – i paguhen të Siguruarit nëse pëson një dëmtim trupor që shkaktohet nga mjete të rastit, të dhunshme, të dukshme, të papritura, apo nga ndonjë shkak tjetër që rezulton në vdekjen e të Siguruarit apo dëmtime të rënda trupore:
  - I. Përfitimi për vdekjen Aksidentale
  - II. Përfitimi për fraktura
- ***d)*** ***Shpenzimet e Riatdhesimit*** - Siguruesi do të paguajë për Riatdhesimin e të siguruarit, nëse gjatë udhëtimit (brenda kufijve të Shqipërisë) apo qëndrimit në Shqipëri ndodh:
  - I. Vdekja e të siguruarit sipas kushteve të kësaj kontrate.
  - II. I siguruari është i dëmtuar rëndë dhe/ose riatdhesimi i tij kërkon kushte të veçanta transporti të rekomanduara nga mjeku specialist.

1.2 E Drejta për të qenë i Siguruar

a) Sipas kushteve të kësaj police gëzojnë të drejtën për t'u siguruar të gjithë personat nga mosha 1 deri në 65 vjeç që vijnë në Shqipëri si vizitorë.

1.3 Përfitime të Pagueshme

1. Me policën e Sigurimit të Jetës së Vizitorit ofrohet mbulim për:

a) Jetën;
b) Shpenzimet mjekësore;
c) Aksidentet personale;
d) Riatdhesimin.

1.4 Përjashtime

Ky sigurim nuk prezumon marrjen përsipër të paguajë për:

1. Shpenzimet që janë paguar nga një policë sigurimi ose nga një program privat mjekësor, si dhe shpenzimet që realizohen në Kosovë;
2. Shpenzimet e riatdhesimit të cilat janë të paguara pa aprovimin e Siguruesit
3. Shpenzimet e bëra për mjekimin e gjendjes mendore ose nervore.
4. Vizitat e zakonshme të syrit, veshit, ekzaminimet mjekësore ose kontrollet periodike të tyre, mjekimin e zakonshëm të dhëmbëve, vënien e dhëmbit fals ose protezave.
5. Kirurgjinë kozmetike fakultative dhe mjekimin shoqërues.

6. Pagesat që kalojnë çmimin e arsyeshëm dhe të zakonshëm për shërbimet dhe furnizimet e kryera.
7. Shpenzimet e pretenduara nga një person që udhëton në kundërshtim me këshillat e mjekut dhe të Siguruesit.
8. Kërkesa për dëmshpërblim nga një person që qëllimisht kërkon të përfitojë trajtim mjekësor.
9. Kërkesa për dëmshpërblim nga persona të cilëve u është dhënë, (përpara se të blejnë policën) një diagnozë për një sëmundje të rëndë dhe të pashërueshme si dhe ata që vuajnë nga AIDS.
10. Humbjet e bagazheve që ka marrë me vete ose ka blere përveçse si dhe sa është përcaktuar në Seksionin V.
11. Vdekjen e ndodhur për shkak fatkeqësive natyrore, kontaminimit radioaktiv, luftës, revoltave të brendshme, kryengritjes së armatosur.
12. Vdekjen si pasojë e vetëvrasjes, ose vetë-ekspozimit në rreziqet e veçanta (përveç përpjekjeve për të shpëtuar jetë njerëzore), si dhe në rastet e shkaktuara nga përdorimi i drogës dhe alkoolit.
13. Vdekjen e ndodhur si pasojë e akteve të kryera me dashje nga Përfituesi në dëm të të Siguruarit.
14. Shpenzimet e kryera për ndërhyrje kirurgjikale apo trajtim mjekësor që sipas opinionit të mjekut specialist në mënyrë të arsyeshme mund të shtyheshin derisa i siguruari të kthehej në vendin e banimit.
15. Ekzaminimet mjekësore ose kontrollet të bëra me kërkesë dhe dëshire të të siguruarit.
16. Shtatzëni normale dhe kostot e lindjes së fëmijës
17. Kërkesa për dëmshpërblim për vdekjen natyrore për personat mbi 65 vjeç

1.5 Taksat dhe Tatimet

a) Taksat dhe tatimet e detyrueshme sipas ligjit janë në ngarkim të Policëmbajtësit dhe/ose të Përfituesve.